



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**V E N D I M**

**NR. 15/13, DATË 15 / 07 /2021**

**PËR**

**MIRATIMIN E STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK  
PROCEDURË E VEÇANTË” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “RESORT  
TURISTIK DELTA FALAISE RESORT & VILLAGE ZONA 2, 3, 4 & 5” ME  
SUBJEKT APLIKUES SHOQËRIA "DELTA" SH.A. ME NIUS K13127202W**

Në mbështetje të Nenit 9, 17, 18, 21 dhe 22 të Ligjit Nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

**VLERËSOI:**

- Subjekti aplikues propozon zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një strukture turistike në Zonën Kadastrale 1481, mes zonës së Drimadhës dhe Palasës, Bashkia Himarë, me vlerë investimi 154,964,433 Euro, realizimi i të cilës parashikon të hapë 200 vende të reja pune. Projektimi i këtij investimi të propozuar është realizuar nga studio ndërkombëtare e mirënjohur dhe zhvillimi i këtij projekti parashikon standarde të larta të aplikuara.
- Subjekti është i pajisur me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 15/6 datë 04.02.2021, me të cilin i është miratuar për fazën e parë statusi “investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”. Faza e parë të realizimit të këtij projekti parashikon ndërtimin e një Resorti me 5 yje, që do të përbëhet nga 1 ndërtesë 3 katëshe me një lartësi maksimale prej 12 metrash dhe një kapacitet prej 440 dhomash, i cili do të ofrojë shërbime cilësore e me standarde të larta në fushën e

turizmit dhe mikpritjes;

- Aplikimi aktual parashikon realizimin e fazës 2, 3, 4 dhe 5 së të njëjtit projekt investimi.
- Sipërfaqja totale e projektit është afërsisht 257,989 m<sup>2</sup> nga ku 26,000 m<sup>2</sup> janë pronë private dhe 231,989 m<sup>2</sup> pretendohet të jenë pronë shtet, pasi zona ende nuk ka regjistrim fillestar.
- Vlera e investimit të projektit “Resort Turistik Delta Falaise Resort & Village Zona 2, 3, 4 & 5” me subjekt aplikues shoqëria "Delta" sh.a. me NIUS K13127202W plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë 154,964,433 (njëqind e pesëdhjetë e katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind e tridhjetë e tre) Euro.
- Projekti plotëson kriteret e punësimit të kërkuara nga legjislacioni për investimet strategjike. Përgjatë realizimit të investimit dhe operimit, numri i personave të punësuar parashikohet të jetë 200 (dy qind) persona.
- Subjekti ka lidhur kontratë me brand ndërkombëtar.
- Masat kryesore mbështetëse që kërkon subjekti aplikues për realizimin e këtij projekti investimi në zbatim të nenit 27 dhe nenit 29 të Ligj Nr.55/2015, i ndryshuar, janë vënie në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore për zhvillimin e investimit, e drejta e përdorimit të brigjeve të detit si dhe zonës përkatëse të plazhit në funksion të realizimit të një projekti investues strategjik.

Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka konfirmuar se janë verifikuar koordinatat e zonës bregdetare të cilat janë pjesë e listës së stacioneve bregdetare sipas VKM Nr. 1172, datë 24.12.2020 ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 171, datë 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të verpimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar. Agjencia Kombëtare e Bregdetit konfirmon se parcelat HI-3 dhe HI-4 janë të lira dhe janë parashikuar për investime strategjike, sipas Aneks 3 të këtij vendimi.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

## **KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

### **VENDOSI:**

1. Miratimin e Statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë” për projektin e investimit “Resort Turistik Delta Falaise Resort & Village Zona 2, 3, 4 & 5”.
2. Projekti “Resort Turistik Delta Falaise Resort & Village Zona 2, 3, 4 & 5” do të realizohet nga subjekti "DELTA" sh.a. me NIUS K13127202W.
3. Projekti strategjik parashikon realizimin e investimit në sektorin strategjik të turizmit.
4. Projekti do të zhvillohet në Zonën Kadastrale 1481, mes zonës së Drimadhës dhe Palasës Bashkia Himarë.
5. Sipërfaqja totale e projektit është afërsisht 257,989m<sup>2</sup> nga ku 26,000m<sup>2</sup> janë pronë private dhe 231,989m<sup>2</sup> pretendohet të jenë pronë shtet. Sipërfaqja ndërtimore parashikohet të jetë 149.523 m<sup>2</sup> mbi tokë.

**Zona 2** përmban një territor për zhvillim prej 47,972 m<sup>2</sup> dhe ka në përbërje vila individuale rezidenciale. Në këtë zonë parashikohen të ndërtohen 5 tipologji vilash të cilat variojnë me sipërfaqe nga 318 m<sup>2</sup> deri në 688 m<sup>2</sup>. Numri total i vilave që priten të ndërtohen është 29.

**Zona 3** do të jetë një zonë e dedikuar për zhvillimin e njësive akomoduese. Në këtë zonë parashikohet ndërtimi i 1 Hoteli me 5 Yje. Hoteli do të ketë 245 dhomave të standardeve të larta dhe ambiente shërbimi.

**Zona 4** do të zhvillohet në një sipërfaqe totale prej 141,756 m<sup>2</sup>. Zona do të ketë një zhvillim miks ku përfshihen vila rezidenciale, apartamente, njësi shërbimi, ndërtesa sociale kulturore dhe Apartment-Hotels. Në zonë parashikohet të ndërtohen afërsisht 660 njësi. Do të ndërtohen sheshi Palasë dhe sheshi Llogara të cilët do të shërbejnë si qendra të fshatit turistik.

**Zona 5** parashikon zhvillimin e ambienteve reaktive dhe të gjelbra të cilat do të jenë në funksion të pushuesve dhe/ose rezidentëve të zonave të tjera. Sipërfaqja totale e kësaj zonë parashikohet të jetë 28,203 m<sup>2</sup>.

6. Statusi “Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë” i jepet projektit të investimit “Resort Turistik Delta Falaise Resort & Village Zona 2, 3, 4 & 5”, për një

periudhë 4 (katër) vjeçare, përveç afatit të lejimit të përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse së plazhit si dhe afateve të lejimit të përdorimit të pasurive të paluajtshme shtetërore, të cilat vendosen me Vendim të Këshillit të Ministrave, sipas legjislacionit të investimeve strategjike.

7. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, përkatësisht neni 21, 22, 24, 27 dhe neni 29 i Ligj Nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, masat mbështetëse që i jepen projektit janë si më poshtë:

- a) Miratohet masa mbështetëse e kryerjes së procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;
- b) Miratohet masa mbështetëse e asistencës në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit, në përputhje me afatet e parashikuara sipas legjislacionit të investimeve strategjike ;
- c) Miratohet në parim masa mbështetëse konsolidim toke, në përputhje me nenin 21, pika c, të Ligj Nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.433, datë 8.6.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të MTM dhe të ish-Komunave/Bashkive”.
- d) Miratohet në parim masa mbështetëse vënie në dispozicion të pasurisë së paluajtshme në pronësi të shtetit shqiptar, në ZK 1481 për zhvillimin dhe realizimin e këtij projekti investimi strategjik, pas regjistrimit fillestar të zonës. Duke qenë se sipërfaqja ku do të zhvillohet ky projekt, sipas Aneks 1 bashkëlidhur, shtrihet në afërsi me kufirin e monumentit natyror (MN) “Delta e Përroit të Palasës”, shpallur me VKM Nr. 303, datë 10.05.2019 “Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar të monumenteve të natyrës Shqiptare”, kategoria e III e zonave të mbrojtura, subjekti aplikues "DELTA" sh.a. me NIUS K13127202W të respektojë dhe të zbatojë me korrektësi kushtet e lejes mjedisore, përgjatë vijës ndarëse me kufirin e monumentit. Kufiri i MN “Delta e Përroit të Palasës” dhe koordinatat gjenden në Aneks 2 dhe Aneks 3 bashkëlidhur këtij vendimi. Zhvilluesi nuk i lejohet asnjë lloj

veprimtarie brenda këtij monumenti dhe duhet të kryejë punime rehabilituese nëpërmjet mbjelljeve me pemë të ndryshme dekorative, lule e bar duke krijuar kështu një brez të gjelbër miqësor me mjedisin.

Në zbatim të nenit 27 të Ligj Nr. 55/2015, i ndryshuar, miratimi përfundimtar i masës mbështetëse të mësipërme, për të gjitha fazat e projektit, do të rregullohet me Vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi të turizmit mbi zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, lidhur me mënyrën dhe afatet e vënies në dispozicion të këtyre pasurive të paluajtshme në pronësi të shtetit shqiptar, me qëllim realizimin e strukturave akomoduese turistike të parashikuara në këtë projekt investimi, pas regjistrimit fillestar dhe pasi të jenë kryer të gjitha verifikimet e nevojshme, për sa i përket saktësisë të vendndodhjes (parcelat e detajuara), sipërfaqes, statusit të tyre juridik dhe për aq kohë sa nuk ekzistojnë mosmarrëveshje administrative dhe/ose gjyqësore me shtetin në pasurinë objekt të investimit strategjik.

8. Në zbatim të nenit 29 të Ligj Nr.55/2015, i ndryshuar, miratohet në parim masa mbështetëse e lejimit të përdorimit të brigjeve të detit si dhe zonën përkatëse të plazhit përballë kompleksit, por në asnjë rast për një afat më të gjatë se 30 (tridhjetë) vjet. Duke qenë se koordinatat e përdorimit të bregut të detit që kërkon subjekti, sipas Aneks 4 të këtij vendimi, i përkasin formave të ndryshme të menaxhimit, koordinatat e përdorimit të bregut të detit, të cilat mund të vihen në dispozicion të këtij projekti investimi nëpërmjet një Vendimi të Këshillit të Ministrave do të duhen të saktësohen nga verifikimet në terren të Bashkisë Himarë brenda parcelave HI-3 dhe HI-4, të cilat janë pjesë e listës së stacioneve bregdetare sipas VKM Nr. 1172, datë 24.12.2020 ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 171, datë 27.03.2019 ‘Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të verpimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar. Parcelat HI-3 dhe HI-4, sipas Aneksit 5 të këtij vendimi, janë të parashikuara për investime strategjike, sipas përcaktimeve:

Parcela HI-3

Pika 1 E 465594.61 N 4447461

Pika 2 E 465605.11 N 4447484.1

Pika 3 E 465730.41 N 4447415.5

Pika 4 E 465717.81 N 4447398

Parcela HI-4

Pika 5 E 465736.01 N 4447385.4

Pika 6 E 465761.91 N 4447412

Pika 7 E 465844.51 N 4447333.6

Pika 8 E 465856.41 N 4447351.8

Referuar koordinatave të tjera të plazhit, të cilat kanë formë tjetër menaxhimi, do të duhet marrëveshje me strukturën kompetente.

Miratimi përfundimtar, planvendosja e vijës bregdetare sipas stacioneve të miratuara të plazhit dhe tarifa e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse së plazhit në funksion të realizimit të projektit investues strategjik do të përcaktohen nëpërmjet një Vendimi të Këshillit të Ministrave, pas verifikimeve në terren dhe konfirmimeve nga Bashkia Himarë.

9. Mënyrat, procedurat, afatet dhe organet zbatuese për ofrimin e masave mbështetëse përcaktohen edhe në planin e veprimit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
10. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik “Resort Turistik Delta Falaise Resort & Village Zona 2, 3, 4 & 5” konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e veçantë, Komiteti i Investimeve Strategjike ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.
11. Ky vendim i njoftohet investitorit si dhe publikohet në regjistrin e investimeve strategjike.
12. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për fillimin e regjistrimit fillestar të zonës dhe për paraqitjen dhe përditësimin e të gjitha ndryshimeve të nevojshme në regjistrin kadastral lidhur me zonën në zhvillim.
13. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për të propozuar në Këshillin e Ministrave vendimin për vënie në dispozicion të pasurisë së paluajtshme shtetërore për realizimin e projektit të investimit strategjik “Resort Turistik Delta Falaise Resort

& Village Zona 2, 3, 4 & 5”, përfshirë dhe fazën e parë të projektit miratuar me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 15/6 datë 04.02.2021, në zbatim të legjislacionit në fuqi për zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, pas regjistrimit fillestar të zonës.

14. Ngarkohet Bashkia Himarë për verifikime në terren dhe për të konfirmuar planvendosjen e vijës bregdetare sipas stacioneve të miratuara të plazhit dhe tarifën e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse së plazhit në funksion të realizimit të këtij projekti investues strategjik.
15. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për të propozuar në Këshillin e Ministrave vendim për lejimin e përdorimit të brigjeve në funksion të realizimit të projektit investues strategjik “Resort Turistik Delta Falaise Resort & Village Zona 2, 3, 4 & 5”, përfshirë edhe fazën e parë të projektit miratuar me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 15/6 datë 04.02.2021.
16. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për monitorim të realizimit të projektit të investimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

## **PLANI I VEPRIMIT**

### **PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK “RESORT TURISTIK DELTA FALAISE RESORT & VILLAGE ZONA 2, 3, 4 & 5”**

#### ***1. Përmbajtja e planit të veprimit***

Plani i veprimit për realizimin e një projekti strategjik, përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuara brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;
- Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza;

#### ***2. Zbatimi i planit të veprimit***

Plani i veprimit ndiqet dhe zbatohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin.

Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejtuara. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t'i japin Agjencisë, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet, mendimet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

#### ***3. Informacione të përgjithshme mbi Planin e Veprimit të projektit “Resort Turistik Delta Falaise Resort & Village Zona 2, 3, 4 & 5”***

Ky plan veprimi për realizimin e Projektit të Investimit “Resort Turistik Delta Falaise Resort & Village Zona 2, 3, 4 & 5” përcakton masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e projektit investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit.

Plani i veprimit, u hartua nga grupi operacional i krijuar pranë Agjencisë Shqiptare të



Zhvillimit të Investimeve, bazuar në karakteristikat e projektit të propozuar. Për këtë qëllim, propozuesi i investimit strategjik, ka listuar dhe treguar qartësisht në momentin e paraqitjes së aplikimit, procedurat, shërbimet, dhe masat mbështetëse konkrete, të cilat kërkon të përfitojë nga shteti shqiptar, për realizimin e investimit.

Plani i veprimit u hartua pasi propozimi i paraqitur mbi investimin strategjik të Projektit “**Resort Turistik Delta Falaise Resort & Village Zona 2, 3, 4 & 5**” është vlerësuar paraprakisht dhe ka një rekomandim pozitiv të Komitetit të Investimeve Strategjike në lidhje me miratimin e tij. Autoriteti përgjegjës për miratimin e planit të veprimit për çdo projekt strategjik të miratuar është Komiteti i Investimeve Strategjike.

#### **4. Hapat procedurale**

Propozimi nga investitorët:

Investitori "DELTA" sh.a. me NUIS K13127202W kur paraqiti projektin e investimit strategjik tek AIDA, në përputhje me legjislacionin ka specifikuar edhe listën e procedurave, shërbimeve dhe masat mbështetëse që kërkon për realizimin e investimit strategjik.

Masat mbështetëse që kanë një vlerësim pozitiv nga KIS janë si më poshtë vijon:

<b>Masat e kërkuara</b>	<b>Rekomandimi</b>	<b>Institucioni përgjegjës</b>	<b>Procedura për masën e kërkuar e detajuar ne faza. Detyrimet sipas institucioneve përgjegjëse</b>	<b>Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti</b>	<b>Afati</b>	<b>Kosto</b>
Duke qenë se projekti parashikohet të zhvillohet në një sipërfaqe totale prej 257,989 m <sup>2</sup> , e cila pretendohet që në pjesën më të madhe të jetë në pronësi të shtetit, investitori strategjik kërkon vendosjen në	<b>Po me kusht</b> regjistrimin fillestar të zonës dhe shpalljes ZPZT.  Gjithashtu, meqenëse sipërfaqja ku	MTM AKZM	Kjo masë parashikohet në Nenin 27 “Përdorimi i pasurive të paluajtshme shtetërore për realizimin e investimeve strategjike” në Ligjin Nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e			

<p>dispozicion e kësaj pasurie publike nëpërmjet mekanizmit 1 Euro/99 vjet.</p>	<p>do të zhvillohet ky projekt shtrihet në afërsi me kufirin e monumentit natyror (MN) “Delta e Përroit të Palasës, për të evituar dëmtimet dhe ndikimet e mundshme të monumentit natyror gjatë kryerjes së punimeve, subjekti zhvillues duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të respektojë dhe zbatojë me korrektësi kushtet e lejes mjedisore,</li> <li>- përgjatë vijës ndarëse me kufirin e monumentit, zhvilluesi të kryejë punime rehabilituese nëpërmjet mbjelljeve me pemë të</li> </ul>		<p>Shqipërisë”. Legjislacioni në fuqi ku do të mbështet kjo masë do i referohet legjislacionit të turizmit mbi ZPZT.</p>			
---	---	--	--	--	--	--

	ndryshme dekorative, lule e bar duke krijuar kështu një brez të gjelbër miqësor me mjedisin, të evitojë ndërtimet.					
Mundësimi i hedhjes së zonës së zhvillimit në sistemin e ZRPP dhe fillimin e procesit të regjistrimit fillestar për të gjithë territorin që ndikon në mënyrë direkte apo indirekte në zhvillimin e resortit turistik.	PO	ASHK	Referuar kreut V, neni 30, pika 9, Ligjit 111/2018 “Për kadastrën“ kryerja e këtij regjistrimi, bëhet vetëm nga ASHK-ja si institucion i vetëm i cili merret me inventarizimin dhe regjistrimin fillestar të pronave.			
Kërkohet marrja në përdorim të bregdetit përpara kompleksit, me një afat 30 vjeçar i cili siguron kthimin e plotë të investimit të kryer në këtë zonë nga Investitori Strategjik.	Po	MTM Bashkia Himarë AKZM	Kjo masë parashikohet në nenin 29 të Ligj Nr.55/2015, i ndryshuar.  Masa miratohet me VKM, propozimin e të cilit në Këshillin e Ministrave e bën MTM.	Verifikimet në terren, konfirmimi i planvendosjes sipas stacioneve të miratuara të plazhit për zonën në fjalë dhe tarifa e përdorimit konfirmohen nga Bashkia Himarë.  Referuar		

				koordinatave të tjera të plazhit, të cilat kanë formë tjetër menaxhimi, do të duhet marrëveshje me strukturën komptente.		
Mundësimin e lidhjes me rrjetin ekzistues të energjisë elektrike dhe sigurimi i kapacitetit të fuqisë dhe lidhjes për zhvillimin normal të aktivitetit të kompleksit.	Po me kusht		<p>Kostot e plota për të siguruar lidhjen me rrjetin ekzistues elektrik deri te pika e lidhjes së përcaktuar nga OSHEE të mbulohen nga pala që kërkon të lidhet në rrjet. Ref. Ligji Nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", Neni 28, "Kostot për lidhjen me rrjetin".</p> <p>Linjat për furnizimin me energji elektrike apo linja të tjera, nuk duhet të shtrihen në sipërfaqe të monumentit natyror.</p>			

<p>Furnizimi me ujë të pijshëm për një kapacitet të mjaftueshëm për kompleksin, duke mundësuar lidhjen dhe furnizimin me ujë në rrjetin e Bashkisë Himarë.</p>	<p>Po me kusht</p>		<p>Kostot e plota për lidhjen me ujësjellësin ekzistues të mbulohen nga pala që kërkon të lidhet në rrjet</p> <p>Linjat për furnizimin me ujë të pijshëm nuk duhet të shtrihen në sipërfaqe të monumentit natyror.</p>			
<p>Planifikimi i nevojave për largim të ujërave të ndotura, duke u lidhur me infrastrukturën ekzistuese nëpërmjet pikës së shkarkimit KUZ në pjesën veriore të kompleksit.</p>	<p>Po me kusht</p>		<p>Kostot e plota për lidhjen me KUZ ekzistues të mbulohen nga pala që kërkon të lidhet në rrjet.</p> <p>Linjat për largimin e ujërave të ndotura, nuk duhet të shtrihen në sipërfaqe të monumentit natyror.</p>			
<p>Përshpejtim i afateve të procedurave shtetërore që kanë lidhje me këtë projekt, veçanërisht procesin e miratimit të lejes së ndërtimit dhe të gjithë lejeve apo licencave të tjera të nevojshme për zhvillimin e projektit.</p>	<p>Po</p>		<p>Masa mbështetëse parashikohet në nenin 24 të Ligj Nr. 55/2015, I ndryshuar</p>			

Suport në realizimin e rrugës së re e cila mundëson akses më të përshtatshëm me kompleksin dhe zonën e kategorizuar si Zonë me Përparësi Zhvillimi Turistik	Po me kusht		Aksesi në infrastrukturë të mundësohet nga subjekti.			
---	-------------	--	--	--	--	--

**KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**